



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2024

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion dt 29.07.2024 administruar pranë bashkisë Shkodër me nr 15929 prot dt 29.07.2024 , më poshtë do të gjeni linkun e publikimit të Planit Lokal të Veprimit për energji dhe klime 2023-2030 , Plan ky i miratuar me Vendim të Keshillit të Bashkisë Shkodër nr 34 dt 31.05.2024.

<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Plani-Lokal-i-Veprimit-per-Energji-dhe-Klime.pdf>

Në vijim të kërkesës tuaj ju bej me dije sa më poshtë:

Ky plan sic edhe shihet është miratuar në maj pra kur është miratuar buxheti i vitit. Pavarësisht kësaj nga strategjitë kryesore të bashkisë është “tranzicioni i gjelbër” , kjo strategji gjithëpërfshirëse do të kontribuojë në kursimin e energjisë, rritjen e përdorimit të burimeve të energjisë diellore, erës, hidroenergjisë dhe reduktimin e CO2.

Adresimi i sfidës së efikasitetit të energjisë nëpërmjet përdorimit të burimeve të mëdha të energjisë së rinovueshme duke ofruar përmirësime të Eficiencës së Energjisë në përgjithësi , por kryesisht për të gjitha shërbimet e drejtpërdrejta bashkiake (ndërtesat dhe shërbimet publike), pa hequr fokusin e saj edhe në gjithë sektorët indirekt si sektori rezidencial, turizmi, shërbimi privat dhe tregtar, industria, bujqësia dhe transporti privat.

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me partnere të ndryshëm, (SECO, Agjencia për EE, FSHZH) si edhe me fonde të buxhetit të vet ka nderhyrë në përmirësim të ndricimit publik duke e kthyer këtë ndricim në LED në rreth 45 km rrugë si në qytetin e Shkodrës ashtu

edhe ne NJA Velipoje. (kjo perkthehet ne kursim energjie , CO2 dhe lek nga buxheti i bashkise).

Eshte nderhyre nepermjet donatoreve te ndryshem ne vendosjen e paneleve fotovoltaike per prodhim Enrgjise ne 3 objekte publike (kopeshte , shkolla) do te nderhyet shpejt edhe ne 7 objekte te tjere (shkolla) duke patur ne plan nje nderhyrje komplekse ne funksion te permiresimit te performances se energjise ne ndertesa (publike) ne rreth 15 objekte te tjera.(me nje siperfae te rehabilituar rreth 14.000 m2).

Referuar sektorit rezidencial (shumefamiljar/pallate) , bashkia ne bashkepunim me FSHZH, AEE , eshte duke nderhyre ne mbi 60 objekte te tilla duke bere veshjet me kapote te tyre , ne nje siperfaqe mbi 100.000 m2.

Në fushën e transportit : Vete bashkia ka shtuar flotën e automjeteve te saj me 5 automjete / vetura elektrike shoqëruar me instalim te karikuesve elektrike.

- Procesi i buxhetimit kryhet çdo vit me pjesëmarrjen e publikut. Bashkia organizon çdo vit dëgjesa me publikun sipas një kalendari takimesh të publikuar ne faqen zyrtare. [Këshillim me Publikun - Bashkia Shkoder](#). Kjo në zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“.

Takimet organizohen ne çdo njësi administrative dhe lagje të qytetit.

- Akoma nuk ka një program specifik për edukimin apo informimin e komunitetit mbi eficensen e energjisë, por bashkia nëpërmjet Drejtorisë se Mjedisit dhe Energjisë se Rinovueshme organizon çdo vit aktivitete informuese/sencibilizuese me nxënësit e shkolla për mbrojtjen e mjedisit ne përgjithësi dhe për eficensen e energjisë ne veçanti (sipas kalendarit te aktiviteteve).
- Sfidat kryesore për zbatimin e masave të eficenses se energjisë janë sigurimi i fondeve (mjeteve fianaciare) për zbatimin e tyre, pasi këto masa kërkojnë

ndërhyrje me kosto të mëdha financiare të cilat nuk mund të realizohen vetëm me buxhetin e bashkisë Shkodër.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETAR

Benet BECI